

KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 03, datë 14.02.2020

**Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 38, datë 20.12.2019 “Mbi miratimin e termave të referencës dhe kritereve të përzgjedhjes të Audituesit të Brendshëm të Specializuar, për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6, nenit 17, pika 1 dhe të nenit 18 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, si dhe të nenit 42, pika 2 dhe pika 2/1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozim të Grupit të Punës për hartimin e termave të referencës dhe kritereve të përzgjedhjes të audituesit të brendshëm, i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 94 datë 28.10.2019, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

**V E N D O S I:**

1. Në aneksin me titull “Termet e referencës për shërbimin e auditimit të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Drejtues nr. 38, datë 20.12.2019, në seksionin XII “Kriteret e kualifikimit”, në nëntitullin “Kapaciteti teknik”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“1. Duke patur parasysh natyrën e veçantë të veprimtarisë së Agjencisë, subjekti duhet të ketë eksperiencë në fushën e auditimit të jashtëm ose të brendshëm të bankave, Bankës së Shqipërisë ose Agjencisë.



## KËSHILLI DREJTUES

- a) Kur shërbimi është realizuar me institucione publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga institucioni publik për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate.
- b) Kur shërbimi është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Vlera e këtyre kontratave duhet të jetë jo më pak se 40% e fondit limit.”


- a) Në pikën 2, shkronja “b” ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“b) Drejtuesi i ekipit që do të angazhohet në auditimin e Agjencisë duhet të ketë certifikim ndërkombëtar “Auditues i Brendshëm” (CIA) ose ekuivalente me të ose certifikatën e lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si “Auditues i Brendshëm në sektorin publik” dhe të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë pune si auditues i jashtëm ose i brendshëm. Drejtuesi duhet të ketë qënë anëtar ekipi në auditime të jashtme ose të brendshme në banka, Bankën e Shqipërisë ose në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. Për të vërtetuar këtë operatori duhet të paraqesë, CV-në, kontratën e punës dhe certifikatën profesionale përkatëse.”

- b) Në pikën 2, shkronja “d” ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“d) Anëtarët e tjerë të ekipit duhet të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në fushën e auditimit të brendshëm ose të jashtëm dhe certifikim ndërkombëtar (CIA/ACCA) ose ekuivalente me to ose të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si “Auditues i Brendshëm në sektorin publik”. Për të vërtetuar këtë operatori duhet të paraqesë, CV-të, kontratën e punës dhe certifikatat profesionale përkatëse.

Për të paktën dy anëtarë të ekipit (përfshirë drejtuesin e ekipit), subjekti duhet të paraqesë listë pagesat (formularët E-SIG 025/A të dorëzuar te organet tatimore) ose vërtetim për pagim kontributesh të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën Qershor – Dhjetor 2019.



## KËSHILLI DREJTUES

2. Ngarkohet njësia e prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**